



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 3026
V E N D I M

NR. VENDIMI 6675

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

Alma KODRALIU – GJYQTARE

Asistuar nga sekretar gjyqësor Enis Hysolli, sot me date 23.07.2018, mori në shqyrtim, çështjen civile nr. regjistrimi 3026, lidhur me:

PADITËS:*, ***, adresa ***, përfaqësuar nga Znj. ***, me prokurë të posacme, e lejuar nga gjykata.**

E PADITUR: *, ***, adresa ***, përfaqësuar nga Av. ***.**

OBJEKTI: Heqjen e emrit “**” nga emri tregëtar i të paditurit.**

Mospërdorimi i shprehjes “**” në asnjë nga reklamato audio e vizuale nga i padituri dhe heqjen e kësaj shprehje në të gjitha reklamato ekzistuese që ai disponon.**

Pushimin e publikimit të reklamave e të paditurit nga Radio “**”, me emrin tregëtar të paditësit.**

Shlyerjen e dëmshpërblimit moral prej * lekë shkaktuar nga shfrytëzimi e cenimi i reputacionit dhe emrit të paditësit nëpërmjet reklamimit e emrit tregëtar të tij sikurse është i të paditurit.**

BAZA LIGJORE: Neni 13, 32, 153, 154, 154/a i K.Pr.Civile dhe Nenet 246 e vijues, 348 të K.Pr.Civile, nenet 608 e vijues të K.Civil, Nenet 1 e vijues, 140 e vijues 141, 144, 156, 184 e vijues të Ligjit 9947 datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale” të ndryshuar. Marka e regjistruar “**” numër *** datë *** pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Neni 23 e 44 I Ligjit 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar.**

Gjykata, në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi dëgjoi palën paditëse, e cila parashtroi pranimin e padisë si të mbështetur në ligj dhe në prova, si dëgjoi palën e paditur e cila kërkoi rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj e në prova, ia nënshtroi hetimit gjyqësor e çmoi provat e paraqitura dhe shqyrtoi çështjen civile në tërësi;

VËREN :

Se pala paditëse * është regjistruar si *** më dt. **, në ushtrimin e veprimtarisë në fushën e agjencisë së eveteve dhe balerinave profesioniste; ofrim i shërbimit të kërcimit artistik dhe argëtues; krim i bashkëpunimeve me të tretë për ofrimin e kërcimeve profesionale ; ofrim i shërbimeve të marketingut dhe promocionit; bar, ***, club. Këtë**

aktivitet paditësi e ka regjistruar me emrin tregëtar « *** ». Ndërkohë, më dt. 26.02.2016 është regjistruar në Drejtorinë e Markave dhe Patentave për një periudhë 10 vjecare, marka me nr. Regj. ***, që kishte të bënte me siglën « *** », ngjyra të mbrojtura: lejla, e zezë dhe e bardhë. Kjo markë e regjistruar përfshihet në klasën « 35 » që ofron shërbime argëtimi, agjensi eventesh dhe balerinash profesioniste, shërbime të kërcimit artistik dhe argëtues, shërbime të promocionit dhe marketingut si dhe në klasën « 43 » si club nate.

Ndërkohë e paditura ***, është *** e regjistruar më dt. 13.04.2017 me fushë të veprimtarisë « klub nate » nën emrin tregëtar « ***** », në adresën ***. Emri tregëtar i palës së paditur është regjistruar më dt. 02.06.2017.

Paditësi ka pretenduar se më parë e ka ushtruar aktivitetin në ambientin ku sot e ushtron aktivitetin pala e paditur në *** me të njëjtin lloj aktiviteti dhe më dt. 02.05.2017 ai e ka zhvendosur në ambientin e ri, të regjistruar edhe sot pranë OKB. Paditësi ka pretenduar se përmes reklamave, ka ardhur në dijeni se pala e paditur po zhvillonte të njëjtin aktivitet si ai. Ai ka pretenduar se kjo gjë momentalisht nuk e shqetësoi, por më tej, në Qershor 2017 ai erdhi në dijeni të shfrytëzimit të emrit të tij tregëtar nga e paditura. I është drejtuar palës së paditur për heqjen vullnetarisht të reklamave që përmbajnë emrin e tij tregëtar dhe pushimin e cenimit të së drejtave të tij, por nga pala e paditur nuk ka pasur asnjë reagim. Sipas të paditurit, emri tregëtar me të cilin pala e paditur ushtron aktivitetin është “***” dhe sipas të paditurit “***” janë fjalë identike që vetë paditësi ka të mbrojtur si markë në reklamat publicitare të biznesit të tij. Po sipas paditësit, pala e paditur e reklamon aktivitetin e saj në radio (konkretisht Radio ***) përmes logos “***”.

Paditësi pretendon se pala e paditur duhet ta heqë nga emri tregëtar i saj fjalët “***” dhe “***”, pasi këto fjalë kanë të bëjnë me emrin tregëtar që përdor paditësi dhe përdorimi i këtyre fjalëve ka për qëllim që të hutojë konsumatorin, pasi pala e paditur e kryen veprimtarinë e vet në po të njëjtin ambient ku më parë e ka ushtruar paditësi. Si rrjedhojë, sipas paditësit, konsumatorët duke parë që emri tregëtar është i njëjtë, e po ashtu edhe shërbimet që ofrohen dhe si pasojë mendon se shërbimet që ofrohen janë të palës paditëse, por në të vërtetë konsumatori është mashtruar pasi bizneset janë tërësisht të ndryshme.

Si pasojë, paditësi ka pretenduar se përdorimi i emrit “***” dhe “***” nga e paditura janë veprime të jashtëligjshme dhe i kanë sjellë dëm mortal paditësit në reputacionin dhe emrin e tij, pasi duke u përdorur emri i tij tregëtar dhe duke u përpjekur të duket si paditësi, i padituri ka dalsur të shfrytëzojë reputacionin që ka fituar biznesi i paditësit, i cili ka dy vite që është në treg.

Pala paditëse ka pretenduar se:

Si emri “***” si emri “*** ***” që pala e paditur përdor publikisht është i ngjashëm me emrin tregëtar që përdor paditësi, ndërsa fjala “***” është identike me emrin tregëtar të paditësit, i cili e ka të regjistruar si markë. Qëllimi i markave tregëtare është të bëjë dallimin Brenda shërbimeve të të njëjtit lloj, ndërmjet personave fizik të ndryshëm nëpërmjet emrave tregëtar. Kështu, pala e paditur e reklamon veten me fjalën “***” që është identike me emrin tregëtar të paditësit dhe mbi të gjitha ofron shërbimin “***”. Pala e paditur nuk mund të përdorë fjalën “***” apo emra të tjerë të ngjashëm me markën në pronësi të paditësit sepse nuk e ka të regjistruar si markë, e

për pasojë ai nuk ka të drejtë ta përdorë as si fjalë në emrin e tij tregëtar e as të reklamojë veten me këtë emër.

Për të kuptuar që shërbimet e ofruara nga pala e paditur janë të njëjta me ato që ofron paditësi mjafton të shihet akti i ekspertimit i realizuar nga gjykata. Po kështu nisur nga fakti se vendi I ushtrimit të aktivitetit nga pala e paditur është I njëjtë me atë ku paditësi e ka ushtruar këtë aktivitet më parë, ka pasur për qëllim hutimin e konsumatorit. Imitimet që I padituri bën duke përdorur emrin “***” si reklamë si dhe duke bashkëshoqëruar e përfshirë fjalën “***” në emrin tregëtar ndërkohë që kjo fjalë është e regjistruar cenon të drejtën e paditësit për ekskluzivitetin emrejt tregëtar.

Pala e paditur pretendon se marka “***” është në pronësi të saj, por në fakt është paditësi ai që e ka regjistruar i pari. Pala e paditur po e trajton këtë gjyq si mënyrë për njohjen e emrit që kopjon si markë të sajën, ndërkohë që njohja e markave rregullohet me ligj të vecantë. Pala e paditur ngatërron objektin e padisë, pasi çështja që parashtrohet nuk ka të bëjë me pronësinë e markës, pasi ajo është e zgjidhur, paditësi është pronari. Çështja ka të bëjë me pushimin e cenimit të së drejtës së fituar prej paditësit për pasjen e një marke tregëtare ekskluzive që i përket vetëm atij, e që askush tjetër nuk mund ta përdorë.

Pala e paditur pretendon se fëmijët e saj *** dhe *** mbrojnë të drejtën për emrin tregëtar të Znj. ***, e cila është e vetmja e paditur nga paditësi. Personat e tjerë nuk kanë lidhje me paditësin dhe ata nuk kanë dëmtuar markën në pronësi të tij, e po kështu nuk kanë lidhje me mosmarrëveshjen. Pranimi i akteve apo fakteve nga *** dhe *** shkel nenet 5,6,9,16,28 e 29 të K.Pr.Civile.

Në seancë pala e paditur ka deklaraur se ka paraqitur aplikim pranë Drejtorisë së Pronësisë Industriale për regjistrimin emrit të ngjashëm “*** ***”, ndërkohë që pikërisht emri tregëtar që paditësi përdor është i ngjashëm. Duke u përpjekur të regjistrojë emrin tregëtar si të vetën pranë një organi administrativ, pala e paditur e ka dërguar çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor.

Lidhur me dëmin e shkaktuar paditësit, vëmë në dukje se veprimet e jashtëligjshme i kanë sjellë dëm moral në reputacionin e paditësit pasi duke u përpjekur të duket si paditësi e duke e imituar atë, i padituri ka dashur të shfrytëzojë reputacionin që ka fituar biznesi i paditësit i cili ka dy vite në treg. Kopjimi i emrit tregëtar ka sjellë si pasojë marrjen e klientelës së paditësit, të cilët janë mashtruar nga emri dhe vendi ku ndodhet I padituri.

Pala e paditur ka prapësuar se:

Pretendimet e paditësit nuk qëndrojnë pasi emrat tregëtar të dy palëve ndërgjyqëse nuk janë as të njëjtë dhe as të ngjashëm. Po të shihet kuptimi etimologjik i emrit të palës së paditur, ai është në gjuhën angleze “***”, ndërsa emri tregëtar i palës tjetër është në gjuhën spanjolle “***”. Është pikërisht ana formale që bën dallimin e dukshëm mes dy emrave.

Në lidhje me përmbajtjen e këtyre dy emrave tregëtar në përkthimin e tyre “***” – do të thotë “zonja e parë ***”, ndërsa “***” përkthehet “ e mira ***”.

Lidhur me regjistrimin në QKB, në bazë të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007, regjistrimi i emrit tregëtar kryhet në bazë të paraqitjes së aplikimit. Kujtojmë se regjistrimin në fillim e ka kryer vajza e të paditurës, Znj. *** më dt. ***, me nr. NIPT ***. Në këto kushte, pretendimi i palës paditëse se e ka regjistruar më parë bie poshtë.

Pala paditëse pretendon se pala e paditur përdor emrin tregëtar “*** ***”. Përderisa ajo nuk përdor emrin “***” ka të drejtë të reklamojë aktivitetin e vet me shkurtimet apo me emrin e plotë. Po kështu, sjellim në vëmendje se reklama e subjektit tonë ka adresë të dnryshme nga pala paditëse.

Lidhur me pretendimin për shpërblimin e dëmit moral, sjellim në vëmendje se pala e paditur nuk I ka sjellë asnjë dëm palës paditëse dhe përfitimet e saj kanë ardhur pikërisht prej punës së palës së paditur dhe jo nga pala paditëse.

Pasi u njoh me pretendimet dhe prapësimet e palëve, gjykata paraprakisht vlerëson se referuar objektit dhe bazes ligjore te kerkese-padise si dhe përpos shpjegimeve të palëve ndërgjyqëse çmon se referuar Nenit 6 të K. Pr. Civile percaktohet se: “Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”. Nga ana tjetër Neni 16/1 përcakton se “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dipsozitat ligjore..... Gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës. Në Nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.”. Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor. Cilësimi juridik i fakteve bëhet në përputhje me cilësimin ligjorë të tyre dhe gjykata u jep mundësi të njëjta palëve që të parashtrojnë pretendimet dhe provat e tyre, duke u kujdesur në krverjen e një hetimi të plotë e të gjithanshëm gjyqësor. Në këtë drejtim edhe pretendimi i palës paditëse se pranimi i provave nga pala e paditur që të vërtetonin pretendimet e saj konsiderohet shkelje e neneve 5,6,9,16,28 e 29 të K.Pr.Civile.

Konkretisht, rezulton se pala paditëse më dt. 25.11.2015 ka paraqitur kërkesën për regjistrimin e markës “****”, adresa e pronarit ***, është regjistruar në ***. Kjo markë është regjistruar më dt. *** dhe gëzon mbrojtje deri më dt. *** (sipas certifikatës nr. *** për regjistrim marke, lëshuar me nr. *** datë *** nga Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave). Paditësi pretendon se më në Maj 2017 e ka zhvendosur aktivitetin e tij në ambientin e ri, ku ushtron edhe sot taktivitetin, me pot ë nëjtin emër tregëtar.

Pala e paditur ka prapësuar se në ambientin ku paditësi pretendon se e ka ushtruar aktivitetin më pare, ka qenë regjistruar në emër të ***, për ushtrimin e aktivitetit “Lokal nate me muzikë”, që në vitin 2013, duke paraqitur si prova edhe lejen mjedisore. Po kështu nga pala e paditur është paraqitur si provë shkresa e Njesisë Bashkiake nr. 2 dt. 19.12.2013 nr. Prot. ***, sipas të cilës “Znj. *** është subjekt fizik dhe kërkon mendimin nga NJësia BASHkiake nr. 2 për ushtrimin e aktivitetit në lokalin me muzikë “****”. Ky aktivitet zhvillohet në katin përdhe të një objekti shumëkatësh përballë *** në anën lindore të ***.Në këto kushte Njësia Bashkiake nr. 2 jep pëlqimin e saj për zhvillimin në këtë ambient të veprimtarisë muzikore ...”. Po kështu pala e paditur ka paraqitur si provë edhe një kontratë qiraje nr. *** datë *** lidhur mes qiradhënëses *** dhe qiramarrëses *** për objektin me sipërfaqe *** m2 në *** për një periudhë prej pesë vitesh. Pavarësisht se ky dokument është thjesht fotokopje, pala paditëse thjesht ka kërkuar mosmarrjen e provave që kanë të bëjnë me *** dhe *** dhe nuk ka pasur pretendime se këto prova kanë elemente falsiteti në to. Pavarësisht se nuk është e rëndësishme në zgjidhjen e çështjes, gjykata e përmend këtë provë, pasi është në raport edhe me provat e tjera, me qëllim paraqitjen e një tabloje të qartë të mosmarrëveshjes dhe mënyrës se si ajo ka evoluar. Po kështu,, Znj. *** në këtë ambient më dt. 16.10.2013 ka regjistruar si person fizik aktivitetin e saj “klub nate” me emrin tregëtar “****”, aktivitet i cili rezulton aktiv, por mbi të cilin janë vendosur masa e

sekuestros konservative mbi kuotat që disponon *** (sipas shënimit në ekstraktin e regjistrit tregëtar).

Ndërkohë, sipas ekstraktit të regjistrit tregëtar, rezulton se *** , person fizik, më dt. 07.01.2015 në po të njëjtin ambient *** , ka regjistruar aktivitetin “klub nate” me emrin tregëtar “***”, aktivitet i cili është c regjistruar më dt. 25.10.2017. Pala e paditur ka prapësuar se paditësi ka ushtruar fillimisht si punonjës dhe më pas së bashku me ta aktivitetin derisa më pas është larguar. E paditura në seancë gjyqësore ka pohuar se ka qenë paditësi ai që ka pasur ide për evoluimin e mëtejshëm të aktivitetit, si psh. krijimin e pistës së vallëzimit, etj, por aktiviteti ka qenë regjistruar nga fëmijët e saj.

Lidhur me këto prapësime të palës së paditur, paditësi nuk ka sjellë ndonjë provë që të kundërshtojë ato, dmth, se ai vetë në këtë adresë ka pasur të regjistruar në emër të tij aktivitet me këtë emër, kohën e regjistrimit, etj, por thjesht ka kërkuar mosmarrien e provave të paraqitura nga pala e paditur, prova të cilat u lejuan nga ana e gjykatës me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë e të gjithanshëm gjyqësor. Nga ana tjetër, nisur nga fakti se për gjykatën nuk kishte rëndësi për zgjidhjen e kësaj çështje, edhe gjykata nuk zgjeroi hetimin gjyqësor në drejtim të kërimit të provave në këtë drejtim palës paditëse, megjithatë, pranoi kërkesën për prova të palës së paditur.

Lidhur me zgjidhjen e çështjes, gjykata vëren se në nenin 140 i Ligjit Nr. 9947 dt. 07.07.2008 “Per pronesine Industriale” (ne fuqi ne kohen e ngritjes se kerkese-padise) percakton se:

“1. Cdo shenjë ose kombinim shenjash, që paraqitet grafikisht dhe që shërben për të dalluar mallrat apo shërbimet e një personi fizik ose juridik, nga ato të një personi tjetër fizik ose juridik, është markë që përfaqëson ato mallra ose shërbime, me kusht që të përmbushen kërkesat e neneve 141 deri në 143 të këtij ligji (në vijim do të quhet “markë”).

2. Përbëjnë marka shenjat e mëposhtme:

a) fjalët, përfshirë emrat personalë, shkronjat, numrat, shkurtimet;

b) shenjat figurative, përfshirë vizatimet;

c) format dy ose tredimensionale, format e mallrave dhe/ose ambalazhimi i tyre;

ç) kombinimet e ngjyrave e të dritë-hijeve, si dhe ngjyrat në vetvete;

d) çdo kombinim i shenjave, të përmendura nga shkronjat “a” deri në “ç” të kësaj pike.

3. Markat regjistrohen vetëm nëse ato mund të paraqiten grafikisht. Kjo lidhet veçanërisht me lloje të veçanta markash, si zëri dhe sinjalet e dritës, por jo vetëm me këto.”

Neni 143 i Ligjit percakton se: “1. Marka nuk mund të mbrohet nëse përdorimi i saj bie në kundërshtim me të drejtat e mëparshme.2. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo duhet të deklarohet e pavlefshme kur: a) është e njëjtë me një markë të mëparshme dhe mallrat e shërbimet, për të cilat është aplikuar ose regjistruar ajo, janë identike me mallrat ose shërbimet, për të cilat është mbrojtur marka e mëparshme; b) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, e cila mbrohet për mallra apo shërbime identike ose të ngjashme dhe kur, për shkak të njëllojshmërisë ose të ngjashmërisë, ekziston mundësia e shkaktimit të konfuzionit te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes me markën e mëparshme; c) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, edhe kur është për t’u regjistruar ose është regjistruar për mallra apo shërbime, që nuk janë të ngjashme me ato, për të cilat është regjistruar marka e mëparshme, kur marka e mëparshme ka një

reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe përdorimi ose regjistrimi i markës në fjalë, pa shkak të arsyeshëm, fiton prioritet të padrejtë ose dëmton natyrën dalluese apo emrin e mirë të markës së mëparshme.3. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nëse cenon të drejtat e mëparshme, të fituara, si: a) të drejtën e emrit tregtar, me kusht që ky emër ose pjesa thelbësore e tij të jetë e njëjtë apo e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet, dhe që pronari i emrit tregtar të prodhojë apo të sigurojë përkatësisht mallra ose shërbime, të njëjta ose të ngjashme me ato të markës, që kërkohet të regjistrohet;b) të drejtën e një personi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e të cilit është e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet;c) të drejtat e pronësisë industriale, përfshirë emrat e varieteteve të mbrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe të treguesve gjeografikë;c) të drejtat e autorit të një vepre ose të një pjese të saj, me kusht që ajo të jetë e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të mbrohet.

4. Marka nuk mbrohet, nëse është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të regjistruar, për mallra apo shërbime të njëjta ose të ngjashme dhe nëse vlefshmëria e saj ka mbaruar për shkak të mbarimit të afatit të mbrojtjes, për një periudhë gjashtëmujore nga mbarimi i këtij afati.

5. Markë e mëparshme, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, vlerësohet:

a) marka, me një datë aplikimi për regjistrim më të hershme sesa data e aplikimit për regjistrim e një marke tjetër tregtare, duke pasur parasysh, kur është rasti, pretendimin për prioritet për atë markë, sipas nenit 147 të këtij ligji;

b) marka, që është regjistruar më parë, nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë;

c) aplikimi për një markë, sipas përcaktimit të shkronjave “a” e “b” të kësaj pike, në varësi të regjistrimit të tyre;

c) marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, të publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit, në përputhje me parashikimet e DPPM-së dhe të autoriteteve ndërkombëtare.”

Neni 156 i Ligjit PI, paragrafi 2, parashikon: “Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën të ndalojë personat e tretë të përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij: a) një shenjë, që është e njëjtë me markën, për mallra dhe shërbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka; b) një shenjë, që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëllojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulojnë nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare; c) një shenjë të njëjtë ose të ngjashme për mallra apo shërbime, edhe kur këto nuk janë as të njëjta e as identike me ato, për të cilat është regjistruar marka, në rast se marka ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshëm, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i mirë i markës”.

Neni 184/2 i ligjit përcakton se: “Përbën shkelje të së drejtës, sipas rastit, çdo përdorim, kufizim, imitim ose bashkëshoqërim i paautorizuar i disenjos së regjistruar, markës apo treguesit gjeografik, si dhe çdo veprim tjetër që cenon të drejtat e pronarit, sipas neneve 127, 156 dhe 178, të këtij ligji. I njëjti rregull zbatohet edhe për disenjon, markën apo treguesin gjeografik të depozituar në DPPM, për të cilin është bërë kërkesë për regjistrim, sipas këtij ligji.”

Neni 6 bis i Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale nga 30 marsi i vitit 1883, i amenduar «1) Vendet e Unionit obligohen, qoftë sipas detyrës zyrtare, nëse e lejon legjislacioni i atij vendi, qoftë me kërkesë të palës së interesuar, të refuzojnë ose anulojnë regjistrim dhe ndalesë të përdorimit të shenjës fabrikimi ose tregtare që përfaqëson riprodhim, mbështetje ose përkthim, ashtu i realizuar që të mund të krijojë konfuzion me ndonjë shenjë që autoriteti përkatës i vendit të regjistrimit ose përdorimit do të konsideronte se në atë vend padyshim është i njohur si shenjë e personit që gëzon të drejtën për ta përdorur me këtë konventë dhe të përdoret në produkte të llojit të njëjtë ose të ngjashëm. Në të njëjtën mënyrë do të procedohet edhe nëse pjesa e rëndësishme e shenjës përfaqëson riprodhim të ndonjë shenje të tillë që padyshim është i njohur ...e mund të krijojë konfuzion me atë shenjë. 2) Një afat më i shkurtë, prej pesë viteve, duke llogaritur nga data e regjistrimit, duhet të jepet për kërkesë për fshirjen e shenjës së tillë. Vendet e Unionit mund të parashikojnë një afat në të cilin mund të kërkohet ndalesë përdorimi. 3) Nuk do të përcaktohet afat për kërkesë për fshirje ose ndalesë përdorimi të shenjave të regjistruara ose të përdorura me qëllim të keq.»

Nga sa më sipër, gjykata vëren se ndodhet para faktit që pala paditëse e ka regjistruar si markë emrin dhe logon “***” së bashku me ngjyra të mbrojtura lejla, e zezë, e bardhë. Ndërkohë, pala e paditur nuk ka regjistruar dhe mbrojtur ndonjë markë pranë Drejtorisë përkatëse. Në këtë drejtim, pavarësisht pretendimeve të palës së paditur se ka qenë ajo e para e cila e ka hapur këtë aktivitet me këtë emër, është paditësi ai që e ka regjistruar i pari dhe objekt i këtij gjykimi nuk është regjistrimi i rregullt ose jo i kësaj marke nga paditësi, por cenimi nga ana e të paditurës, i markës së regjistruar prej tij. Në këto kushte, kombinimi i fjalëve “***” me shenjat, vizatimet, ngjyrat, etj, përbëjnë markën e mbrojtur nga paditësi.

Çështja e cila në rastin konkret shtrohet për diskutim është nëse përdorimi i fjalëve “***” dhe “***” nga ana e palës paditëse sjell konfuzion tek publiku, për shkak të përdorimit të të njëjtave fjalë, nisur nga natyra e njëjtë e veprimtarisë së ushtruar nga palët ndërgjyqëse.

Pavarësisht se nga ana e të dy palëve ndërgjyqëse u pranua fakti se ato ushtronin të njëjtën natyrë aktiviteti, me qëllim verifikimin nga ana e saj të një fakti të tillë, me qëllim verifikimin e shenjave dhe fjalëve me të cilat pala e paditur reklamonte aktivitetin e saj, në një krahasim edhe me aktivitetin dhe reklamimin e palës paditëse, gjykata caktoi një ekspert i autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, për dizenjot, market dhe treguesit gjeografikëduke i lënë atij si detyrë verifikimin e cdo shenje dalluese të aktivitetit të secilës prej palëve ndërgjyqëse, nëpërmjet fotove të marra në vend, në hyrje, ambientet e brendshme, kartëvizita, vendeve ku reklamoheshin aktivitetet, etj.

Sipas ekspertit, paditësi ***, në aktivitetin e tij përdor si emër tregëtar “*** ***”, markë të cilën e ka të regjistruar pranë DPPI-së me siglën “***”, nr. Marke *** datë ***. Aktivitetin aktual paditësi e ushtron në adresën Rr: *** ndërsa adresën e mëparshme të aktivitetit e ka pasir në Njësinë Administrative nr. 2, ***, adresë në të cilën ushtron aktivitetin pala e paditur me emrin e regjistruar në QKB “*** ***”. Marka e regjistruar “***” është në klasën 35 që ofron shërbime argëtim, agjensi eventesh dhe balerinash profesioniste, shërbime të kërcimit artistic dhe argëtues, shërbime të promocionit dhe marketingut, e po kështu edhe në klasën 43 si club nate.

Sipas ekspertit, nga vëzhgimi i subjektit “*** **” vërehet se ofron të njëjtat shërbime me ato të palës së paditur, ngjyrat në sfond janë e kuqe, lejla, e bardhe, e zezë, ndërsa ngjyra që mbrohen në kuadër të markës së regjistruar janë lejla, e bardhe dhe e zezë. Sipas ekspertit, të dy ambientet përveçse ushtrojnë të njëjtin aktivitet kanë edhe ngjashmëri në dizenjo, duke i pasqyruar në mënyrë fotografike të dy ambientet në fjalë. Nga ana e ekspertit janë nxjerrë edhe përfundime, të cilat nuk janë marrë parasysh nga ana e gjykatës, pasi së pari nuk i janë kërkuar dhe së dyti kanë të bëjnë me trajtime juridike, të cilat nuk janë në misionin e ekspertit.

Në lidhje me faktin nëse përdorimi i emrave “***” dhe “***”, paraprakisht gjykata vëren se pala paditëse ka të mbrojtur vetëm togëfjalëshin “***”. Fjala “***” as nuk është e mbrojtur dhe as nuk mund të mbrohet si fjalë, pasi ka të bëjë me përcaktimin apo përshkrimin e një natyre aktiviteti. Kjo fjalë mund të përdoret lirisht nga cilido aktivitet i të njëjtës fushë. Kështu që pretendimi se paditësja duhet të heqë emrin “***” nga reklamat e saj dhe nga emri tregëtar është një pretendim që nuk ka bazë ligjore, pasi kjo fjalë është në një farë mënyrë përcaktuese e natyrës së aktivitetit të palëve ndërgjyqëse.

Në lidhje me përdorimin e fjalës “***”, gjykata vëren se ky emër është i regjistruar nga paditësi në kuadrin e markës së mbrojtur, megjithëse, në kundvështimin e gjykatës, kjo fjalë nuk do të duhej të ishte regjistruar si e mbrojtur, pasi pasur parasysh natyrën e aktivitetit, pasur parasysh normat dhe ndjeshmërinë e një kategorie të caktuar të popullatës, përdorimi i kësaj fjale në ushtimin e këtij lloji aktiviteti, mund të konsiderohej në kundërshtim me ndjenjat fetare të tyre. Megjithatë, gjykata, ndodhet përpara faktit kur kjo fjalë tashmë është pjesë përbërëse e markës tregëtare dhe çështja që shtrohet për diskutim është nëse përdorimi i saj prej të paditurës cenon markën tregëtare të mbrojtur apo jo.

Për gjykatën, nëse ka cenim ose jo arrihet duke pasur parasysh kriterin që, dallimi mes dy subjekteve dhe aktiviteve të ushtruara prej tyre, të jetë i tillë që të mos konfondohej nga çdo individ me intelekt mesatar, apo një konsumator i zakonshëm. Normalisht, që kjo dallueshmëri lidhet me emrin, logon, stema, shenja dalluese, si dhe aktivitetin që kryhet. Në këtë drejtim, e rëndësishme është të krijohet bindja se ekziston mundësia e konfondimit dhe jo të provohet vetë ky konfondim.

Nisur nga fakti që: të dy subjektet kanë të njëjtën veprimtari tregëtare në fushën striptizmit; nga fakti se paditësi më parë e ka zhvilluar aktivitetin në të njëjtin vend me palën e paditur me të njëjtin emër (pavarësisht se gjykata u bind se aktiviteti ishte hapur me këtë emër fillimisht nga fëmijët e të paditurës, ka qenë paditësi ai që e ka regjistruar si markë nën emrin e tij dhe ky regjistrim nuk është kundërshtuar); një konsumator i zakonshëm që kërkon atë lloj shërbimi, nga emërtimet e të dy aktiviteve, ajo që do t'i mbetej në mendje me shumë mundësi, mund të ishte fjala “***”, duke krijuar edhe konfuzion mes këtyre dy aktiveve. Për më tepër, gjykata mban parasysh se kjo fjalë është më e dallueshmja nga ana e vizuale në reklamat e palës së paditur, pasi është e shënua me germa dallueshëm më të mëdha se fjalët e tjera. Këtu përmendet edhe fakti se në disa vende ose reklama përdoret vetëm emri “*** **”.

Si rrjedhojë, arrihet në përfundimin se përdorimi i emrit “***” nga ana e palës së paditur cenon markën e regjistruar nga pala paditëse me nr. *** në përbërje të së cilës është edhe togëfjalëshi “***”. Në këto kushte, pala e paditur nuk duhet ta përdorë më

në aktivitetin e saj këtë fjalë dhe duhet ta c rregjistrojë nga emri tregëtar, e po ashtu edhe nga emërtimi apo reklamimi i aktivitetit.

Lidhur me pretendimin e palës paditëse se asaj i është shkaktuar dëm moral nga përdorimi prej palës së paditur i emrit “****”, gjykata vëren se pala paditëse nuk u paraqit asnjë provë në drejtim të provimit të ekzistencës së këtij dëmi. Së pari, pala paditëse nuk është e qartë në kërkimet e saj pasi pretendon se si rrjedhojë e përdorimit të emrit “****” nga ana e të paditurës, kjo e fundit i ka marrë klientelë, duke rritur aktivitetin e saj dhe duke dëmtuar paditësin. Një dëm i tillë ka të bëjë me dëmin material dhe jo atë moral dhe gjykata nuk mund të shprehet tej kërkimeve të palëve, pavarësisht se vihet në dukje se nuk u soll ndonjë provë në gjykim që të vërtetohet se ka ndodhur një fakt i tillë dhe çfarë dëmi material është pësuar konkretisht.

Në lidhje me dëmin moral të pretenduar nga paditësi, ky i fundit ka argumentuar se një dëm i tillë i ka ardhur si rrjedhojë e dëmtimit të reputacionit dhe imazhit të palës paditëse në aktivitetin e ushtruar prej saj si rrjedhojë e përdorimit të emrit “****” nga pala e paditur. Lidhur me këtë pretendim, gjykata vëren se pala e paditur nuk solli asnjë provë që të vërtetonte se ka ndodhur një dëm i tillë. Gjykata vlerëson se pala e paditur nuk duhet ta përdorë më emrin “****” pasi ekziston mundësia e konfondimit mes dy aktiviteteve, por nuk është vërtetuar se ky konfondim realisht ka ekzistuar. Këtu mbahet parasysh edhe fakti se, kategoria e personave që frekuentojnë ambiente të tilla, normalisht duhet të jenë në dijeni të vendeve që i ofrojnë këto shërbime dhe më shumë sesa nga emri tërhiqen nga shërbimi i ofruar. Në këto kushte, nuk mund të prezumohet se përdorimi i emrit “****” nga pala e paditur ka lidhje me reputacionin e aktivitetit të palës paditëse. Nga ana tjetër, se cili nga aktivitetet ka përfutuar nga reputacioni i tjetrit, nuk u provua në këtë gjykim.

Konkretisht, as nuk u pretendua dhe as nuk u provua se pala paditëse ofron shërbim tërësisht më cilësor se pala e paditur dhe se kjo e fundit nëpërmjet shërbimit të dobët ka dëmtuar imazhin e palës paditëse përmes konfondimit të mundshëm si rrjedhojë e përdorimit të emrit “****”. Vetë pala paditëse e ka pranuar në padi se pala e paditur ka shtuar aktivitetin e saj duke u regjistruar në biznes të madh, që do të thotë se ka pasur fitim të konsiderueshëm, pra si rrjedhojë edhe frekuentim të madh, e përkthyer në emër të mirë. Në këto kushte, pala e paditur mund t’i merrte klientelë palës paditëse, duke e dëmtuar ekonomikisht, por jo të dëmtonte reputacionin e mirë të saj, madje në rast konfondimi edhe mund ta ndihmonte. Në këto kushte, një kërkim i tillë është tërësisht i pambështetur në ligj dhe në prova dhe si rrjedhojë duhet rrëzuar.

Shpenzimet gjyqësore përbëhen nga taksa e padisë në vlerën ***lekë parapaguar nga pala paditëse, shpenzime për shërbime noteriale në vlerën ***lekë parapaguar nga pala paditëse, sipas faturës tatimore të shitjes nr. *** datë ***, shpenzime për ekspertin në shumën ***lekë, parapaguar nga pala e paditur. Në total shpenzimet gjyqësore janë në shumën *** i lihen në ngarkim palës

PER KETO ARSYE :

Gjykata bazuar në Nenet 126, 306-308 e vijues të K. Pr. Civile,

VENDOSI :

Pranimin pjeserisht te kerkese-padise.

Heqjen e emrit “*” nga emri tregëtar “*** ***” i regjistruar në QKB për ushtrimin e aktivitetit “klub nate” nga personi fizik ***.**

Ndalimin e palës së paditur, personit fizik * për përdorimin e emrit “***” në reklamat audio dhe vizuale të saj të reklamimit të aktivitetit të saj.**

Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.

Një kopje e këtij vendimi i dërgohet QKB për krverjen e ndryshimit në emrin tregëtar të aktivitetit të palës së paditur.

Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales se paditur.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane, brenda 15 diteve nga e nesermja e shpalljes se tij.

SEKRETAR

GJYQTARE

ENIS HYSOLLI

ALMA KODRALIU